



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË**

**ANALIZA VJETORE E VITIT 2022**

**(Sipas shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm 118/25.01.2023)**



## 1. HYRJE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë, Urdhërit nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë paraqes para Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë Raportin Vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, mbi treguesit sasiorë dhe cilësorë të punës së kësaj Prokurorie si dhe gjëndjen e kriminalitetit per vitin 2022.

Nëpërmjet këtij materiali do të paraqesim treguesit e punës së veprimtarisë së përgjithshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, realizuar gjatë vitit 2022, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin paraprak dhe në gjykim si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore nga Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Njëkohësisht do të parashtrijmë në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, të metat e konstatuara në punën tonë, shkallën e performancës së Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

## 2. MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURIALE

Përgjatë vitit 2022, trupa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka ushtruar me një shkallë të lartë përgjegjshmërie ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq si dhe realizimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj.

**Organika dhe seksionet:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për ushtrimin e veprimtarisë së saj, në fund të vitit 2022, kishte një organikë prej 44 punonjësish definitivë. Nga këta, 13 janë prokurorë (duke përfshirë drejtuesin dhe zv/drejtuesin) 12 janë oficerë të policisë gjyqësore dhe të tjerët punonjës në administratë. Në fakt, për shkak të mungesave në organikë, viti 2022 ka filluar me 7 prokurorë (duke përfshirë drejtuesin) dhe 8 oficerë të policisë gjyqësore. Gjatë muajve pasardhës organika faktike ka ndryshuar me largime dhe prurje prokurorësh dhe OPGJ dhe përfundoi, në fund të dhjetorit, me 8 prokurorë, 1 drejtues dhe 8 oficerë të policisë gjyqësore. Kjo gjëndje është pasojë e lëvizjeve të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit, pasojë e procesit të rivlerësimit dhe e dorëheqjes të prokurorit në në rast.

### **Tabelë organike numerike e prokurorisë në fund të vitit 2022**

| <b>Funksioni</b>      | <b>Organika</b> | <b>Efektive</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Femra</b> |
|-----------------------|-----------------|-----------------|----------------|--------------|
| Drejtues              | 1               | 1               | 0              | 1            |
| Zv/Drejtues/e         | 1               | 0               | 0              | 0            |
| Prokurorë/ë           | 11              | 8               | 4              | 4            |
| <b>Gjithsej Prok.</b> | <b>13</b>       | <b>9</b>        | <b>4</b>       | <b>5</b>     |
| OPGj                  | 12              | 8               | 6              | 2            |

Administrata sipas organikës përbëhet nga një kancelar, një kryesekretare, një finaciere, dy shoferë, një ftues, një punonjës shërbimi, një punonjës I.T, shtatë sekretare pranë prokurorëve, një koordinatorë, një arkiviste, në ftuese dhe dy punonjëse pastrimi.

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kanë funksionuar rregullisht dy seksione, Seksioni i Posaçëm “Kundër krimit të organizuar, narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi si dhe krimeve të kryera nga subjekte të posaçme”, në përbërjen e të cilit

ka 3 (tre) prokurorë dhe Seksioni “Për të mitur, dhe i jurisdikcionit të veprave penale të përgjithshme, dhe që mbulon çështjet penale të referuara nga Komisaritet Korçë, Devoll, Kolonjë” në përbërjen e të cilit ka pasur sipas periudhave 4 deri 6 prokurorë.

**Pavarësia dhe roli aktiv i prokurorit:** Realizimi i reformës në drejtësi ka sjellë efektet e veta në gjithë sistemin e Drejtësisë, por duhet pranuar fakti që në këtë moment në funksionimit të Prokurorisë, efektet e reformes kanë krijuar jo në pak raste, mbi ngarkesa në hetim të prokurorëve duke shkaktuar edhe cënuar në një farë mase edhe cilësinë e përfundimit të prokurorit në hetim.

Në një periudhë reformash të thella që i përkasin Sistemit të Drejtësisë, në përgjithësi, por edhe figurës ligjore specifike të Prokurorit, ngelet gjithmonë një sfidë me vete gjetja e ekuilibrit të duhur mes nevojës për t’u përshatatur me një formë të re të ushtrimit të ndjekjes penale, efikasitetit të ushtrimit të kontrollit të gjykatës dhe arritjes së rezultateve sa më të kënaqshme përgjatë gjithë procesit të hetimit dhe ajo që është edhe më e rëndësishmja në finalizimin e suksesshëm të procesit të gjyqimit.

Para figurës së një modeli prokurori të pavarur qëndron një detyrim i shtuar për përgjegjshmëri më të lartë, por edhe për rezultate akoma edhe më efikase në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale, në kushtet kur Prokuroria Shqiptare ka funksionuar si një trupë e centralizuar.

**Procedime penale me hetime proaktive dhe veprat penale të rënda:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, i ka kushtuar një rëndësi specifike hetimit proaktiv, hetim i cili në pjesën më të madhe të rasteve është shoqëruar edhe me rezultate të sukseshme që lidhen me arrestimin dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve të veprës penale. Gjatë këtij viti, janë inicjuar një numur i konsiderueshëm rastesh që lidhen me hetimet proaktive por edhe hetime të tjera të thelluara, të cilat kanë kërkuar një nivel bashkëpunimi në rang ndërkombëtar. Hetimet proaktive dhe të thellurara gjatë këtij viti kanë qënë të lidhura kryesisht me veprat penale që lidhen me narkotikët, kryesisht në formën e trafikimit të narkotikëve, por edhe në rastet e ndihmës së ofruar për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror, rrethanë e diktuar nga rritja e paprecedentë e këtyre veprave penale në qarkun e Korçës. Kështu gjatë vitit 2022 kanë qënë objekt i hetimit rreth 102 çështje penale që i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal (rreth 8,5% më shumë se vitin e kaluar), nga të cilat janë përfunduar rreth 26 çështje penale me 58 të pandehur. Ndërkohë është ulur numri i procedimeve penale të trajtuara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, nga 16 procedime në vitin 2021, në 13 procedime në vitin 2022, nga të cilat është përfunduar në hetim 1 procedim. 12 çështje janë trajtuar për veprën penale të vrasjes (të parashikuara nga neni 76-79 të Kodit Penal), nga të cilat 5 çështje me 4 të pandehur janë përfunduar. Ndërkohë që ka patur 5 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, nga të cilat janë përfunduar 3 çështje me 3 të pandehur.

## 2.1 DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor si një organ i pavarur, që garanton mbarëvajtjen dhe kontrollin e veprimeve të saj. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Pikërisht me këtë qasje të re kushtetuese, misioni dhe detyrat e Prokurorisë ngelen një sfidë për vetë institucionin, por edhe në raportet e këtij institucioni me Gjykatën, e cila është kontrollori i veprimeve më të rëndësishme të Prokurorisë gjatë gjithë fazave të ushtrimit të ndjekjes penale.

- a) Udhëzimi nr. 10/2020, specifikisht neni 4 i tij i ka dhënë një dimension të ri luftës kundër veprave penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, pasi ka përqëndruar në një grup të specializuar prokurorësh dinamikën e hetimit të këtij grupi veprash penale. Në këto kushte pritshmëritë për këtë Seksion janë të mëdha.

Në unison edhe me strategjinë qeveritare kundër krimit dhe korrupsionit, por edhe nën ndikimin e pashmangshëm të perceptimit të nevojës për të ashpërsuar politikën penale ndaj asaj kategorie veprash penale që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit, edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor i ka kushtuar një vëmendje të shtuar veprave

penale që lidhen me krimin ekonomik. Ngelet për t'u theksuar fakti që në këtë Prokurori ka funksionuar "Seksioni kundër Krimit të Organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi si dhe krimeve të kryera nga subjektet e posaçme", i krijuar mbi bazën e Udhëzimit nr. 1, datë 20.12.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, por i konfiguruar edhe sipas Udhëzimit nr. 10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për masat administrative dhe procedural për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm".

**2.1.1 Pastrimi i produkteve të veprës penale:** Gjatë vitit 2022 ka patur 8 (tetë) procedime penale të reja, të rregjistruara për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, që ju janë shtuar procedimeve të mbartura nga viti i kaluar. Kanë përfunduar 6 procedime penale (pushuar) dhe **23 kanë mbetur në hetim**. Një problematikë që konstatohet në hetimin e çështjeve penale që lidhen me veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal është mungesa e finalizimit me vendimarrje për dërgimin e çështjeve për gjykim, pasi rezultoi se shumicën më të madh të vendimarrjeve për këto raste e ze vendimi i pushimit. Tipologjia e hetimit të këtyre veprave penale ka qënë në kushtet e pamundësisë së verifikimit të lidhjes shkakësore mes pasurisë së evidentuar dhe produktit të veprës penale për të cilën është dyshuar apo dënuar personi në hetim. Në qarkun e Korçës ka qënë një fenomen tipik edhe emigracioni ekonomik, i cili në mjaft raste ka shërbyer edhe si alibi e personave të dyshuar apo nën hetim për të përlegur pasurinë e tyre. Informaliteti i ekonomisë shqiptare është në fenomen i cili referuar tipologjisë së veprave penale të hetuara në Prokurorinë e Korçës, ka vështirësuar procesin e të provuarit të ligjshmërisë së pasurisë së personin nën hetim për veprën penale të pastrimit i produkteve të veprës penale.

Edhe gjatë vitit 2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit me karakter pasuror "sekuestro preventive", e parashikuar nga neni 275 i K.Pr.Penale në një llogari bankare me vlerë 355.093 euro, 144.646 USD dhe 142.450 lekë, që i përket një shtetasi grek. Në këtë rast subjekti ishte i rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me objekt të aktivitetit shërbime mjeksore, radiologjike dhe mekanizmi i kryer së veprës penale ishin disa transfertat të dyshimta, me origjinë nga shteti grek, me vend tranziti shtetin shqiptar, për t'u kaluar përfundimisht në Zvicër. Kjo çështje penale vijon të jetë në hetim, por metoda kryesore e hetimit të kësaj çështje penale ngelet ndihma juridike e kërkuar në shtetin grek, zvicerian, por edhe kryerja e hetimeve që lidhet me një hetim të thelluar financiar pranë subjektit të rregjistruar si subjekti që merret me shërbime mjeksore dhe radiologjike, që rezultoi të jetë edhe përfituesi i trasaksioneve të mësipërme.

Njëkohësisht në disa procedime penale të hetuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë janë sekuestruar në mjaft raste llogari bankare, referuar trasaksioneve të dyshimta me origjinë shtetin shqiptar, por me vende destinacioni edhe vende të tilla si shteti grek, Bejrut, Liban, shteti francez, etj. Deri në këtë moment procedural rezultoi se drejtimi dhe metodologjia kryesore e hetimit të këtyre rasteve ka qënë e orjentuara drejt kërkimit të ndihmes juridike drejtuar autoriteteve të huaja, në varësi të llojit të trasaksionit të dyshimtë, objekt hetimi. Por në të gjitha rastet, hetimi ka qënë i përqëndruar edhe drejt subjektit dërgues apo pritës të shumave të dyshimta të të ardhurave.

Një tjetër tipologji e veprave penale të hetuara lidhur me veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë kanë qënë edhe rastet e hetimit të fokusuar në ekzistencën e pasurive në disponim të personave për të cilët disponoheshin të dhëna se kishin burime të ligjshme të pasurisë. Në këto raste hetimi është thelluar në identifikimin e pasurive që dispononte personi i dyshuar në territorin e Shqipërisë, por jo vetëm, si dhe në kryerjen e një hetimi të thelluar financiar mbi verifikimin e faktit nëse personi mundej të përlegte pasurinë e


tij me të ardhurat e ligjshme apo jo. Në këto raste organi proçedues ka kërkuar ndihmën e ekspertëve kontabël me qëllim përpilimin e akteve të detajuara të ekspertimit për verifikimin e ekzistencës së përputhjes mes të ardhura të ligjshme dhe pasurisë së evidentuar. Në rastet kur nuk është bërë dot e mundur verifikimi i lidhjes shkakësore mes pasurisë së krijuar dhe produktit të veprës penale, organi proçedues ka referuar materialin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për të vijuar proçedurën e mëtejshme lidhur me pasurinë e dyshimtë.

Një tjetër burim i referimit dhe marjes së indicjeve lidhur me veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” kanë qënë edhe faktet që kanë rezultuar nga hetimi i çështjeve të tilla si “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Kultivimi i bimëve narkotike”, e parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, si dhe në rastet e veprave penale të “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në këto raste, hetimi i veprës penale bazë është shoqëruar edhe me fillimin e kryerjes se hetimit pasuror, që në mjaft raste është shoqëruar me rregjistrimin dhe fillimin e një çështje të mirëfillte penale për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

- i) Në shërbim të prokurorëve për të prokurorëve për të ndihmuar në hedhjen e të dhënave në sitemin “Presto” është vendosur specialisti IT, si dhe sekretaret përkatëse. Si rrjedhojë, në sistemin PRESTO janë hedhur gjithë hetimet pasurore, duke përfshirë edhe ato të mbartura nga vitet paraardhëse dhe mbahet i përditësuar çdo fund muaji.

**2.1.2 Treguesit e masave të sigurimit.** Gjatë vitit 2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë referuar në funksion të procedimeve penale të rregjistruara 465 raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar. Në të gjitha rastet janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë apo ndalimi, dhënë çdo rast arresti është vlerësuar i ligjshëm. Është kërkuar nga prokurori në 268 raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” dhe në 14 raste “arrest në shtëpi”. Gjithashtu në 160 raste prokurori ka kërkuar detyrim për paraqitje dhe në 1 rast garanci pasurore. Kërkesa për “arrest në burg” është pranuar nga gjykata në 250 raste. Në 20 raste gjykata ka dhënë masën “arrest në shtëpi”, në 2 raste “garanci pasurore dhe për rastet e tjera gjykata ka caktuar si masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Në 22 raste prokurori ka kërkuar masë ndaluese dhe gjykata e ka pranuar. Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

| <b>Totali i arrestimeve/<br/>ndalimeve</b> | <b>Lirim i<br/>menjëhershëm<br/>Neni 257</b> | <b>Kërkesa e prokurorisë<br/>Neni 258</b> | <b>Vendimi i<br/>gjykatës<br/>Neni 259</b> |
|--|--|---|--|
| <b>465</b>                                 | <b>0</b>                                     | <b>465</b>                                | <b>465</b>                                 |
| Vleftësime të ligjshme                     |  | 456                                       | 465  |
| Vleftësime të paligjshme                   |  | 0   | 0  |
| Arrest në burg                             |  | 268                                       | 250  |
| Arrest në shtëpi                           |  | 14  | 20   |
| Detyrim paraqitje                          |  | 160                                       | 171  |
| Garanci pasurore                           |  | 1   | 2  |



- Treguesit e masave të sigurimit, referuar edhe qëndrimeve që ka mbajtur gjykata, flasin për një politikë objektive të ndjekur nga prokuroria në lidhje me caktimin e masave të sigurimit. Kujdes i veçantë është treguar në rastet kur personat e dyshuar kanë qënë të mitur, pasi në lidhje me ta, veç moshës janë mbajtur parasysh edhe rrethana të tjera shoqërore e sociale për të qënë sa më objektiv e të kujdesshëm në caktimin e masës së sigurimit. Masa e sigurimit “arrest në burg”, ndaj të miturve është kërkuar vetëm në rastin e veprave penale të rënda, ose në rastin kur ata janë përsëritës në kryerjen e veprave penale. Gjithsesi referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vlerësoj se trupa e Prokurorëve duhet të jetë me e kujdesshme sa i takon kërkesave që lidhen me masat e sigurimit “arrest në burg”, duke lexuar kështu rast pas rasti edhe standartin që vendos apo orienton Gjykata me vendimarrjen e saj.

### 2.1.3

#### 2.1.4 Masat e marra në drejtim të zbatimit të urdhërit penal, marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe gjykimin të drejtpërdrejtë.

**Urdhëri penal:** Gjatë vitit 2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, janë dërguar për miratim të urdhërit penal 23 çështje me 25 të pandehur. Bashkë me çështjet e mbartura në gjykim për miratim urdhëri, ky numër shkon në 34 çështje me 37 të pandehur. Nga këto Gjykata ka miratuar urdhërin në 20 çështje me 20 të pandehur. Gjykata ka kthyer aktet në 7 çështje me 9 të pandehur, nga të cilat 4 çështje janë çuar në gjykatë me kërkesë për dërgim në gjyq dhe 3 të tjera janë në hetim.

**Gjykimi me marrëveshje:** Në gjykatë janë depozituar 12 çështje me 12 të pandehur për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. 5 çështje mbeten ende në gjykim ndërsa për 7 çështje të tjera, gjykata në 1 rast ka miratuar marrëveshjen dhe në 6 çështje ka urdhëruar kthimin e akteve. Çështjet e kthyera, me përjashtim të atyre që janë ende në hetim, janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për dërgim në gjyq.

**Gjykimi i drejtpërdrejtë:** Janë dërguar për gjykim të drejt përdrejtë 7 çështje me 7 të pandehur. Prokuroria ka aplikuar një nga gjykimet e posaçme sikurse është gjykimi i drejtpërdrejtë kryesisht në veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Grafiku i çështjeve në gjykim



2.1.5

2.1.6


2.1.7

**2.1.8 Analiza e treguesve e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2022.** Gjatë vitit 2022 Seksioni i të Miturve ka patur në përbërje të tij dy prokurorë. Janë trajtuar gjithsej 56 të mitur (51 meshkuj, 5 femra), nga të cilat 10 të mitur të mbartur në gjykim (kryesisht për kërkesë për pushim), 10 të mbartur në hetim dhe 36 të regjistruar gjatë vitit 2022. Nga këta, 5 të mitur kanë qënë deri në moshën 14 vjeç, ditën e kryerjes të veprës penale, 15 të mitur në grupmoshën 14-16 vjeç dhe 36 të mitur në grupmoshën 16-18 vjeç. Janë dhënë 20 masa sigurimi, 8 me arrest në burg dhe 12 detyrim paraqitje.

Ka përfunduar hetimi për 35 të mitur, nga këta është vendosur mosfillimi i procedimit për shmangje nga dënimi në 1 rast, në 11 raste është vendosur pushimi për shmangje nga dënimi dhe 22 të mitur janë dërguar për gjykim. Në 77% të rasteve të përfunduara hetimi është kryer brena afatit 1-3 muaj.

Ka përfunduar gjykimi për 14 të mitur, nga të cilët 5 janë dënuar me burgim dhe të tjerët me dënime alternative.

Grafiku i mënyrës të përfundimit të hetimeve për të mitur:



Janë regjistruar gjithsej 16 viktima të mitur (3 meshkuj dhe 13 femra) më së shumti për veprat penale të dhunës në familje dhe të ngacmimit seksual.

Nga ana tjetër, në përputhje edhe me udhëzimin nr. 3, datë 25.11.2013 të prokurorit të Përgjithshëm “Për hetimin e veprave penale, ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, apo dëshmitar, apo i dëmtuar, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ka funksionuar Seksioni i të Miturve, i cili ka hetuar në mënyrë korrekte dhe në respektim të mbrojtjes specifike që iëshhtë atribuar të dyshuarit apo të pandehurit të mitur. Më ndryshimet e ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 të Kodit të Procedurës Penale, saktësisht nga neni 13/4 të këtij Kodi, prej datës 01.08.2017 në kompetencën e këtij Seksioni, kanë qënë edhe hetimi i veprave me viktima apo të dëmtuar të mitur. Në vijim, në respektim edhe të ndryshime ligjore që lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike “Seksionit për të Mitur”, i cili ka krijuar nje eksperiencë të konsiderueshme tashme për të patur një qasje sa më korrekte me frymen e Kodit dhe trajtimit të diferencuar të të pandehurit të mitur.

Në rastet kur personi i pandehur ka qënë i mitur, në vëmendjen specifike të Prokurorisë, por edhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka qënë dhënia e alternativave të dënimit me burgim.

Kërkimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, për të dyshuarit e mitur gjatë vitit 2021 është aplikuar vetëm në tre raste nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të të drejtave procedurale të të miturve dhe aplikimit të një politike penale favorizuese në përputhje me moshën e tyre. Në të gjitha fazat e procedimeve penale ku si persona nën hetim/të pandehur kanë qënë të miturit nën moshën 18-vjeçare nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet në prani të avokatëve mbrojtës dhe në prani të të afërmeve të tyre dhe të psikologëve. Janë respektuar jo vetëm të drejtat procedurale po dhe u është dhënë një trajtim njerëzor në përputhje me moshën e tyre.

Në çështjet me të mitur është patur kujdes që të procedohej me sa më pak raste me arrestime apo ndalime me subjekt procedural të mitur duke i kryer hetimet ndaj tyre në gjendje të lirë dhe me masa sigurimi të lehta si “*Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*” të parashikuar nga neni 234 të K.Pr.Penale. Masa e sigurimit “*Arrest në burg*” të parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale është caktuar vetëm në raste specifike, për të mitur që kanë kryer vepra penale të rënda, ose që kanë qënë recidivisht në kryerjen e veprave penale. Kohëzgjatja e afatit të hetimeve në çështjet me të mitur ka qënë e shkurtër dhe kryerja e veprimeve hetimore janë kryer në mënyrë të përsheptuar. Në masat e dënimit, Seksioni i të Miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka kërkuar për këto subjekte pranë Gjykatës Korçë dënime të lehta dhe aplikimin e dënimeve alternative duke patur parasysh riedukimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe parandalimin e kryerjeve të veprave penale nga ta miturit.

Konstatohet se në pesë raste Seksioni për të Mitur ka konkluduar në shmangien nga ndjekja penale dhe është proceduar me aplikimin e nenit 67 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit

#### **2.1.9** Gjatë këtij viti nuk ka pasur kallzime të ardhura nga **ILDKPI**.

Nga **Kontrolli i Lartë i Shtetit** nuk ka pasur kallzime gjatë vitit 2022. Nga 3 procedime të mbartura në hetim, një procedim është transferuar për kompetencë në SPAK, një procedim është dërguar në gjyq për pushim dhe tjetri është ende në hetim.

#### **2.1.10** Kallzime nga Avokati i Popullit – Nuk ka.

## **2.2**

**Dhunë në familje:** Në grupin e veprave penale të cilave ju është dedikuar një rëndësi specifike nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë është edhe vepra penale e “Dhunës në familje”, e parashikuar nga neni 130/a I Kodit Penal. Referuar impaktit dhe pasojave të drejtpërdrejta, të dukshme, por edhe atyre të cilat nuk mund të vlerësohen në çastin e parë të referimit të veprës penale, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike hetimit të kësaj vepre penale. Njëkohësisht edhe masat e dënimit të kërkuara nga ana e Prokurorisë, por edhe qëndrimeve të mbajtura nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kanë konfirmuar vlerësimin maksimal që i është bërë seriozitetit dhe rrezikshmërisë së kësaj vepre penale. Gjithsesi, përbën fakt të pranuar tashme se referuar edhe mekanizmave të referimit të ngritura si të tilla në nivel rajonal nga ana Bashkisë Korçë, rastet e denoncimit të këtyre veprave penale, qoftë edhe në format e tyre me të lehta janë shumë herë më të larta në raport me qytetet e tjera.

Ndërkohë që sa i takon udhëzimit nr. 17, datë 23.12.2020 Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave dhunës në familje, dhe dhunës më bazë urrejte, ku udhëzim i përgjithshëm ka patur për qëllim unifikimin e masave procedurale në prokurorite me juridiksion të përgjithshëm që hetimet dhe ndjekjen penale në çështjet për vepra penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me baze urrejtje të jene, që ato të përfundohen në afate optimale (shpejta), eficiente, dhe me kërkesa për masa dënimi efektive në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posacem të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimave gra. Në dritën e këtij udhëzimi është treguar një kujdes i shtuar si në drejtim të caktimit të masave të



sigurimit ndaj personave të dyshuar për veprat penale që lidhen me dhunën në familje por edhe në aspektin e masve të dënimit ndaj kësaj kategorie personash të marë si të pandehur.

**Trajtimi procedural dhe etik i viktimave:** Sa i takon përmirësimit të aftësive profesionale të prokurorëve, por edhe oficerëve të policisë gjyqësore, në vështrim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë dy prokurorë magjistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjin nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”. Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Më ndryshimet e ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 të Kodit të Procedurës Penale, saktësisht nga neni 13/4 të këtij Kodi, prej datës 01.08.2017 në kompetencën e këtij Seksioni, kanë qënë edhe hetimi i veprave me viktimë apo të dëmtuar të mitur. Në vijim, në respektim edhe të ndryshimeve ligjore që lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike “Seksionit për të Mitur”, duke krijuar një Seksion me një numër të shtuar prokurorësh për të miturit, i cili do të ketë edhe mundësinë për t’u trajnuar për të qënë në një qasje sa më korrekte me frymen e Kodit dhe trajtimit të diferencuar të të pandehurit të mitur.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të të drejtave procedurale të të miturve dhe aplikimit të një politike penale favorizuese në përputhje me moshën e tyre. Në të gjitha fazat e procedimeve penale ku si persona nën hetim/të pandehur kanë qënë të miturit nën moshën 18-vjeçare nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet në prani të avokatëve mbrojtës dhe në prani të të afërmëve të tyre dhe të psikologëve. Janë respektuar jo vetëm të drejtat procedurale po dhe u është dhënë një trajtim njerëzor në përputhje me moshën e tyre.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktikë është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të “viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paafësi fizike apo intelektuale. Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes së identifikimit të saktë të viktimave dhe specifíkisht rasteve kur do të duhet ti referohemi trashëgimtarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qënë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 i këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proceduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetasi të huaj. Pjesë e rëndësishme e këtij udhëzimi janë edhe gjashtë shtojcat, të cilat I janë vënë dispozicion të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore si modele me të cilat duhet të operojnë në rastet e nevojshme.

Sa i takon Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”.

Njohja me këtë Udhëzim i ka shërbyer prokurorëve që në zbatim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë dy prokurorë magjistratë

të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjirn nr. 37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të mitur”.

Prokurororëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi I çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktikë është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të “viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paaftësi fizike apo intelektuale.

Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes se identifikimit të saktë të viktimave dhe specifikisht rasteve kur do të duhet ti referohemi trashëgimtarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qënë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 I këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proceduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetasi të huaj.

Pjesë e rëndësishme e këtij udhëzimi janë edhe gjashtë shtojcat, të cilat I janë vënë dispozicion të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore si modele me të cilat duhet të operojnë ne rastet e nevojshme.

**b)** Rezulton se gjatë vitit 2021 është shpallur moskompetenca për 19 procedime penale. Vendimet në lidhje me shpalljen e moskompetences dhe kalimin e akteve në 2 raste i është drejtuar SPAK dhe 17 raste të tjera janë dërguar për shkak të komptencës tokësore Prokurorive të Rretheve Gjyqësore.

**c)** Pra prokurorët kanë vendosur dërgimimin në gjykim të 433 procedime penale, ose 48% të procedimeve të përfunduara, 240 çështje janë dërguar në gjyq për pushim, 220 çështje janë pezulluar dhe 19 çështje janë transferuar. Nga 433 çështjet e dërguara për gjykim, 23 çështje apo 4% janë dërguar për miratim të urdhërit penal, 7 çështje apo 1% janë dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë dhe 4 çështje për gjykim me marrëveshje.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe rezikshmërinë e veprës penale, gjatë vitit 2022, nga 433 procedime penale, që janë dërguar për gjykim, 41 procedime janë dërguar për miratim urdhëri penal (së bashku me çështjet e mbartura në gjykim 52 çështje) dhe 29 procedime për gjykim me marrëveshje (së bashku me të mbartura në gjykim 38 çështje). Gjatë procesit të gjykimit, nga 43 çështje të gjykuara për miratim **urdhëri penal**, në 35 çështje me 35 të pandehur është miratuar urdhëri penal dhe në 8 çështje Gjykata ka vendosur kthimin e akteve. Gjithashtu nga 29 çështje të gjykuara për gjykim me marrëveshje, në 26 çështje është miratuar marrëveshja dhe në 3 çështje Gjykata ka vendosur kthimin e akteve. 36 çështje janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë dhe në 385 çështje gjykata ka pranuar gjykimin e shkurtuar. Prokuroria ka aplikuar një nga gjykimet e posaçme sikurse është gjykimi i drejtpërdrejtë kryesisht në veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

**d) Masat e mara për zbatimin e Rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë**

Të gjitha pikat e Rezolutës të Kuvendit janë trajtuar në në pikat (b) dhe (dh) të kapitullit 2.1.

**dh)** Në zbatim të **udhëzimit të përgjithshëm nr. 4/2021** dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr.79/2021 për zbatimin e rekomandimeve, në unison edhe me strategjinë qeveritare kundër kimit dhe korrupsionit, por edhe nën ndikimin e pashmangshëm të perceptimit të nevojës për të ashpërsuar politikën penale ndaj asaj kategorie veprash penale që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit, edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një vëmendje të shtuar veprave

penale që lidhen me krimin ekonomik. Ngelet për t'u theksuar fakti që në këtë Prokurori ka funksionuar "Seksioni kundër Krimit të Organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi si dhe krimeve të kryera nga subjektet e posaçme", i krijuar mbi bazën e Udhëzimit nr. 1, datë 20.12.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, por i konfiguruar edhe sipas Udhëzimit nr. 10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për masat administrative dhe procedural për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm"

**Bashkëpunimi me policinë gjyqësore:** Lidhur me masat e marra nga drejtuesit e prokurorive, në veshtrim të rritjes së bashkëpunimit me policinë gjyqësore, përmirësimit të përdorimit të metodave speciale të hetimit, prokuroria i ka kushtuar një rëndësi specifike rolit fillestar që ka policia gjyqësore në këtë aspekt, duke siguruar në një numër të konsiderueshëm rastesh trajnime mes oficerëve të policisë gjyqësore në drejtimin e një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ndonëse Prokurori është i ngarkuar me ligj të drejtoje dhe udhëheqë hetimin e çështjes penale, për të menaxhuar në mënyrë të suksesshme ushtrimin efikas të ndjekjes penale, ai duhet të bashkëpunojë me një tërësi hallkash, të cilat në mënyrë të koordinuar do të garantojnë edhe suksesin në menaxhimin e çështjes penale në tërësi. Kështu ngelet vërtet problem cilësia e hetimit si në përpilimin e akteve ashtu dhe në vlerësimin dhe çmuarjen e provave në momentin fillestar të referimit të një materiali kallzues. Ndryshimet e nenit 293/1 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të sjellin një disiplinim akoma edhe më të madh të policisë gjyqësore, për të referuar brenda afatit prej 72 orësh elementet thelbësore të faktit penal që procedohet, burimin e provës si dhe të dhëna të tjera që kanë rëndësi specifike për referimin e veprës penale. Përpos problemeve që lidhen me vlerësimin e materialit fillestar të referuar në Prokurori, nga ana e policisë gjyqësore kërkohet edhe këtë vit një efikasitet më i madh si në përpilimin e akteve gjatë fazës së hetimit, ashtu edhe në sistematizimin dhe organizimin e punës nga ana e oficerëve, të cilët jo në pak raste janë të organizuar dhe planizuar edhe në shërbime të tjera operative për llogari të Drejtorisë Vendore të Policisë, duke cënuar kështu edhe performacën e policisë gjyqësore në hetim. Nga ana tjetër, një problematike tjetër e konstatuar ka qënë edhe mangësia e theksuar e oficerëve të policisë gjyqësore në disa Komisariate si dhe levizjet e shpeshta të oficerëve, veprim i cili pengon specializimin e tyre për protokolle të veçanta të hetimit.

**Bashkëpunimit me Institucione të tjera ligjzbatuese,** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike bashkëpunimit me të gjitha agjensitë ligjzbatuese vendase, por edhe të huaja në funksion të administrimit të të dhënave fillestare për hetimin e çështjeve penale, por edhe në trajtimin e tyre si aleatë në hetimin e çështjeve penale me rëndësi thelbësore për luftimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, hetimin financiar, etj. Megjithatë është shumë e rëndësishme që në fokus të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të vlerësohet me vëmendje specifike përpos punës së tyre të përditshme hetimore edhe nevoja për të organizuar në mënyrë me të shpeshtë takime të përbashkëta të organizuara në nivel kombëtar, por edhe rajonal, pasi shkëmbimi i praktikave më të sukseshme hetimore do të shërbente hetimit të veprave penale që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin, hetimin financiar, evazionin fiskal apo krimin kibernetik. Gjatë vitit 2021 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, që përbën një element shumë të rëndësishëm të suksesit në punën e prokurorisë. Bashkëpunimi i mirë ka funksionuar si në nivel titullarësh, por edhe në nivelin bazë dhe ka dhënë rezultatet e veta. Theksi është vënë në përmbushjen e detyrimeve të policisë gjyqësore, rritjen e nivelit profesional të tyre, eliminimin e zvaritjeve të pa justifikuara dhe rritjen e cilësisë së hetimit me qëllim për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Ka një përmirësim të bashkëpunimit me pushtetet vendore dhe institucionet e tjera lokale me synimin për të marrë prej tyre në kohë informacionin e nevojshëm në interes të hetimit. Edhe përsa i përket ekzekutimit të vendimeve penale, bashkëpunimi me IEVP dhe Shërbimin e Provës Korçë ka qënë mjaft i mirë.

Përsa i përket marëdhënieve të punës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ato kanë qënë korrekte dhe të bazuara në ligj. Ka patur një përmirësim të ndjeshëm të raporteve me këtë gjykatë sidomos për zgjidhjen e problemeve të natyrës administrative.

Me Prokurorinë e Apelit Korçë vazhdojnë të ruhen marëdhënie të mira institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete.

**Posedimi i substancave narkotike:** Referuar edhe pozicionit strategjik të qytetit të Korçës, një nga veprat penale që konstatohet në një numër jo të vogël rastesh, është ajo e posedimit të substancave narkotike me qëllimin final destinimin ndërkombëtar të saj, por edhe shpërndarjen dhe tregtimin e saj në sasi të vogla, por në mjaft raste tregtimi është shndruar në një aktivitet të qëndrueshëm dhe mjaft të organizuar. Pikërisht për këtë shkak, lufta ndaj aktivitetit të kundraligjshëm që lidhet me kultivimin, apo tregtimin e substancave narkotike do vijojë të jetë prioritet i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ngelet për t'u përmendur fakti që kjo Prokurori ka hetuar dhe finalizuar në mënyrë të suksesshme me dhjetra procese gjyqësore që lidhen me grupime kriminale, të cilat në mënyrë shumë të organizuar dhe të qëndrueshme kanë tregtuar substance narkotike. Masat procedurale të mara nga prokurorët lidhur me rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit dhe për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 4/2021, referuar edhe pozicionit strategjik të qytetit të Korçës, një nga veprat penale që konstatohet në një numër jo të vogël rastesh, është ajo e posedimit të substancave narkotike me qëllimin final destinimin ndërkombëtar të saj, por edhe shpërndarjen dhe tregtimin e saj në sasi të vogla, por në mjaft raste tregtimi është shndruar në një aktivitet të qëndrueshëm dhe mjaft të organizuar. Pikërisht për këtë shkak, lufta ndaj aktivitetit të kundraligjshëm që lidhet me kultivimin, apo tregtimin e substancave narkotike do vijojë të jetë prioritet i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ngelet për t'u përmendur fakti që kjo Prokurori ka hetuar dhe finalizuar në mënyrë të suksesshme me dhjetra procese gjyqësore që lidhen me grupime kriminale, të cilat në mënyrë shumë të organizuar dhe të qëndrueshme kanë tregtuar substance narkotike. Kështu gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2021 kanë qënë objekt i hetimit rreth 73 (shtatëdhjetë e tre) çështje penale që i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, nga të cilat janë përfunduar rreth 26 çështje penale, ndërkohë që kanë ngelur në hetim edhe 57 çështje penale. Në gjykim janë dërguar 27 të pandehur, nga të cilët 14 janë proceduar me masën e sigurimit "arrest në burg".

#### **e) Zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, me tregues dhe me spjegime për arritjet dhe problematikat në zbatimin e akteve normative.**

Një element shumë i rëndësishëm që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe në kuadër të zbatimit të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave është edhe zbatimi dhe analizimi në mënyrë të detajuar i Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, analizën e produktivitetit të tyre po e parashtrijmë si më poshtë :

Në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 26.10.2018, "Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", administruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën me nr. 2881 prot, datë 30.10.2018.

Ky udhëzim është bërë objekt i vlerësimeve dhe diskutimeve në Mbledhjen e Prokurorëve, me qëllim individualizimin e kriterëve dhe trajtimin e rregjimit të diferencuar të sekretit shtetëror në raport me sekretin hetimor.

Në vlerësim dhe zbatim të këtij udhëzimi është treguar një kujdes i shtuar për të gjitha veprimet që lidhen me momentin procedural të hyrjes së dokumentave apo materialit të klasifikuar në Institucion, rregjistrimit të tij në Rregjistrin e Korrespondencës së Informacionit të Klasifikuar dhe mandej dorëzimit të tij kundrejt nënshkrimit.

Punonjësi i ngarkuar me administrimin e Rregjistrit të Korrespondencës së Informacionit të Klasifikuar është trajtuar dhe orientuar për të respektuar modalitetet e marjes në dorëzim të objektit postar sipas nenit 3 të këtij Udhëzimi.

Referuar qëndrimeve të ndryshme të mbajtura nga ana e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, por edhe nga Gjykatat e Apelit, në mënyrë specifike, një element, të cilit i është treguar një vëmendje specifike ka qënë neni 7 i këtij Udhëzimi. Nga ana e prokurorëve është kërkuar të kenë një vëmendje të shtuar ndaj detyrimit të mospërfshirjes së informacioneve apo dokumentave të klasifikuara si sekret shtetëror në fashikullin e procedimit penal, duke cënuar integritetin e informacionit, por edhe vetë vlefshmërinë e akteve të procedimit penal apo në tërësi në dosjes penale. Janë sjellë në vëmendje të prokurorëve rastet kur përfshirja e akteve sekrete në dosjen penale ka cënuar vlefshmërinë e dosjes penale dhe të gjykimit penal.

Një kujdes i shtuar është treguar sa i takon edhe faktit që aksesit me informacionet e klasifikuara si sekret shtetëror të jetë atribuar vetëm subjekteve që janë çertifikuar përshtatshëm sipas ligjit. Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 04.03. 2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” janë kryer edhe aplikimet për t’u pajisur me çertifikatë sigurie punonjësit të cilët marrin akses për t’u njohur me informacionet të kategorizuara si sekret shtetëror.

Udhëzimi nr. 4, datë 26.10.2018 “Për përgjimet, administruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën me nr. 2881 prot, datë 30.10.2018.

Ky udhëzim është analizuar dhe trajtuar në mbledhjen e prokurorëve duke u fokusuar në trajtimin analitik të disa çështjeve që janë trajtuar në këtë Udhëzim.

Objekt i diskutimit dhe vlerësimit ka qënë në mënyrë specifike edhe neni 1/5, i cili ka dhënë një definicion për konceptin e “vendit privat”. Në referencë të këtij udhëzimi janë analizuar vendimarrjet e gjykatave shqiptare, por edhe jurisprudenca e Strasburgut, me qëllim evitimin e interpretimeve të gabuara të nocionit të vendit “privat”, në funksion të një nga mjeteve më të rëndësishme të kërkimit të provës, përgjimit.

Në vështrim të këtij Udhëzimi, objekt i diskutimit ka qënë edhe vendimarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në kuptim të kushteve të kërkimit apo lejimit të përgjimit nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në raport me nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi.

Ndonëse dispozitat procedurale penale lidhur me Përgjimet i janë nënshtuar ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, të cilat në vlerësimin tonë nuk përbëjnë një ndryshim thelbësor në këtë mjet të kërkimit të provës, ajo që konstatohet në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është standarti më i lartë i kërkuar nga ana e saj për të lejuar apo vleftësuar kërkesat që lidhen me përgjimet.

Një problem që është konstatuar dhe analizuar nga trupa e prokurorëve janë interpretimet e nenit 5/3 të Udhëzimit e që lidhet specifikisht me rastin kur njëri nga dy personat që do të përgjohen është i gatshëm të kryejë dhe të regjistrojë veprimin përkatës, sipas marrëveshjes me oficerin e policisë gjyqësore. Praktika e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila është mbështetur edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 ka qënë e tillë që është autorizuar vetëm me autorizim të Prokurorit, pa u miratuar kjo kërkesë në Gjykatë. Ndërkohë që vlerësojmë se për efekt të dinamikës së zhvillit të këtij lloji përgjimi, por edhe teknikes legjislative të përdorur në nenin 222/1/2/3/4, do të ishte më praktike dhe efikase që përgjimi i parashikuar nga neni 222/3 të lejohej vetëm me autorizim të prokurorit (ndonëse rregullimi ligjor procedural është i qartë për modalitetin se si duhet të zbatohet).

Prokurorëve ju është kërkuar të sjellin në vëmendje aplikimin e nenit 6 të këtij Udhëzimi, pasi të paktën për tre vitet e fundit kjo dispozitë ka gjetur një zbatim shumë të rrallë, për të mos thënë që nuk është zbatuar fare. Ndërkohë që pas këtij Udhëzimi, kemi patur raste të aplikimit të nenit 6 me qëllim gjetjen e personave të ikur dhe të dënuar me burgim.

Një rëndësi specifike i është kushtuar nenit 8 të Udhëzimit, duke kërkuar një bashkërendim sa më të saktë të veprimtarisë së prokurorëve lidhur me përgjimet (gjatë gjithë dinamikës së tyre) dhe personit të

ngarkuar me administrimin e Rregjistrimit për Përgjimet”. Njëkohësisht në vëmendje të Prokurorëve dhe administratës përkatëse është treguar edhe lidhur me disiplinimin e procesit të rregjistrimit dhe përcjelljes së akteve që lidhen me përgjimit (kërkesat/materialet e përgjuara), elemente të përcaktuara në mënyrë shumë të detajuar edhe në nenin 12 të këtij Udhëzimi.

Njëkohësisht prokurorëve ju është kërkuar që të tregojnë vëmendje edhe në rastet kur i drejtohen Gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes penale, të kërkojnë specifikisht edhe asgjesimin e proces-verbaleve dhe rregjistrimeve të përgjimit telefonik, duke respektuar edhe përjashtimet e parashikuara nga neni 12/4 dhe 12/7 i këtij udhëzimi.

Udhëzimi nr. 1, datë 20.02.2018 “Për krijimin e Seksioneve të posaçme”, në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Lezhë dhe Shkodër për hetimin e veprave penale sipas kompetencës të përcaktuar në Udhëzim, të nxjerë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes nr. 413 prot, e nr.937 prot, datë 02.02.2018 ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm.

Në zbatim të këtij udhëzimi dhe Marrëveshjes mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka disponuar me nxjerjen e Udhëzimit nr. 57, datë 30.04.2018. Njëpërmjet këtij Udhëzimi (bashkëlidhur shkresës) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë krijuar dy seksione. Njeri prej seksioneve ka në kompetencën e tij hetimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin ekonomik si dhe veprat penale që lidhen me substancat narkotike (veprat penale janë specifikuar në udhëzim) ndërkohë që seksioni tjetër, ka në kompetencë hetimin e të gjitha veprave të tjera penale.

Puna e Seksionit ka qënë efektive dhe vlerësoj se është shumë e rëndësishme qëndrueshmëria e përmbajtjes së këtij Seksioni, pasi ndihmon në specializimin e prokurorëve për protokolle të posaçme të hetimit, duke garantuar kështu sukses dhe efektivitet me të madh në hetimin e veprave penale që janë objekt i punës të këtij Seksioni.

Udhëzimi nr. 6, datë 20.11.2018 “Për hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”.

Një nga çështjet që ka qënë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve në raport me këtë udhëzim ka qënë niveli i shtrirjes dhe zbatimit të nenit 3 të këtij udhëzimi. Meqënëse me udhëzimin nr. 6 është rritur shtrirja e veprave penale për të cilat kërkohet verifikimi pasuror, çështjet penale për të cilat mund të kët një disponim qoftë për vendim pushimi të çështjes penale, apo dërgim të saj për gjykim, janë vetëm në nivelin e akteve procedurale dhe nuk janë të shoqëruara me hetim pasuror. Në këto raste, Prokuroritë e Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm duhet të mjaftohen vetëm me dërgimin e akteve procedurale të dosjes hetimore, pa i shoqëruar me aktet e hetimit pasuror, apo në këtë rast duhet të vijojë hetimi pasuror dhe në rastet kur nga hetimi janë siguruar indicje të rëndësishme, ato duhet të referohen Prokurorisë për Krime të Rënda.

Një çështje që i është nënshtruar diskutimeve dhe debateve ka qënë vendosja e ndonjë kriteri objektiv lidhur me rrezikshmërinë e veprës penale, e cila duhet të orjentojë rast pas rasti prokurorët e Rretheve Gjyqësore për fillimin e hetimit pasuror. Konkludojmë kështu, pasi jo në cdo rast hetimi i veprës penale, krijon indicje të mjaftushme për të konkluduar se vepra penale ka gjeneruar të ardhura për subjektin nën hetim. Marim si shembull hetimin e veprave penale që lidhen me posedimin apo tregtimin e substancave narkotike. Në rastet kur sasia e substancës narkotike është vetëm 1 (një) apo 2 (dy) gram (apo sasi të tjera të vogla) dhe vepra penale konsumohet në formën e posedimit apo tregtimit të kësaj sasive, ngelet për t’u vlerësuar nëse duhet vijuar procedura e hetimit pasuror për këtë rast dhe ajo që është edhe më e rëndësishme nëse rezultatet e këtij hetimi duhet të referohen pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.

Në zbatim të këtij udhëzimi, e specifikisht nenit 12 të tij është dokumentuar një rregjistër i veçantë, për rastet e njoftimit të Prokurorisë për Krime të Rënda në lidhje me nisjen e hetimit pasuror si dhe rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale.

Në zbatim të këtij udhëzimi është nxjerë edhe një udhëzim tjetër I përgjithshëm, me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij.

Sa i takon Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”.

Njohja me këtë Udhëzim i ka shërbyer prokurorëve që në zbatim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Proçedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë dy prokurorë magjistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjin nr. 37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të mitur”.

Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktike është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të “viktimës”, trashëgimitarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paafësi fizike apo intelektuale.

Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes së identifikimit të saktë të viktimave dhe specifikisht rasteve kur do të duhet ti referohemi trashëgimitarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qënë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 I këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proçeduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetasi të huaj.

Udhëzimi nr.10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimeve pasurore në Prokuroritë në Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Ky udhëzim është vlerësuar si veçanërisht i rëndësishëm, pasi ka shërbyer për unifikimin e të gjitha masave administrative dhe procedural në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe për hetimet pasurore. Nga ana tjetër edhe zbatimi I nenit 4 të këtij udhëzimi që lidhet me krijimin e Seksioneve të Posaçme kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare ka shërbyer për ti dhënë një impuls të ri luftës ndaj krimin për këtë kategori veprash penale.

Sa i takon Udhëzimit nr. 12, date 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantime pavarësisë, ne prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm, vlerësoj se drejtuesi i prokurorisë duhet të këtë një vëmendje të shtuar për të marrë dhe administruar indicje lidhur me çështjet penale që shfaqin një rëndësi specifike referuar rëndësisë së faktit apo edhe llojit dhe natyrës së tyre. Në këto raste, drejtuesi i Prokurorisë duhet të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, por edhe për të dhënë udhëzime me shkrim, sipas ligjit. Po sipas gëmrës ç të nenit 43, të po të njëjtit ligj, drejtuesi ka për detyrë njëkohësisht edhe të verifikojë ecurinë dhe përfundimin e çështjeve si dhe të japë në dinamikë udhëzime përpara se të meret vendimi për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Në kuptim të nenit 42/dh të


ligjit të sipërcituar drejtuesi i prokurorisë mbikqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve.

Për sa më sipër, ndonëse prokurorët janë dhe duhet të operojnë në pavarësi të plotë dhe në mungesë totale të çdo lloj ndikimi të paligjshëm, pasi në thelb e gjithë puna e prokurorëve është lehtësisht e kontrollueshme nga gjyqtari i hetimeve paraprake, në kuptim dhe analizë të dispozitave të sipërcituara krijohet një lloj dualiteti sa i takon mbikqyrjes së veprimtarisë së prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë. Drejtuesi i prokurorisë, i trupës tashme të decentralizuar ka të drejtën që të kërkojë informacion për çështje konkrete penale, për të nxjerë udhëzime me shkrim me natyrë jo detyruese, për të mbikqyruar ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të çështjes nga ana e prokurorit, por edhe të drejtën për të mbikqyruar disiplinën në punë të prokurorit.

Në këto kushte, roli i drejtuesit të prokurorisë, duhet të jetë një funksion i ushtruar në respektim të pavarësisë së plotë të prokurorit, por edhe në një mbikqyrje të moderuar të drejtuesit, i cili edhe për shkak të ndryshimeve proceduriale merr informacione të plota mbi performancën e prokurorit edhe për shkak të njoftimeve që merr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me qëllim që në thelb të të gjithë procesit të garantohet zbatimi i ligjit material, procedural penal, udhëzimeve të prokurorit të përgjithshëm, por edhe respektimi i protokolleve më të mira dhe shteruese në hetimin e kategorive të veprave të ndryshme penale.

### 2.3 Të dhëna dhe shjegime krahasuese për performancën

- **Treguesit sasiorë të kallzimeve penale:** Gjatë vitit 2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë rregjistruar gjithsej 1.726 kallzime dhe referime për vepra të ndryshme penale, nga të cilat 41 të ardhura me transferim. Janë rregjistruar gjithsej 1.266 procedime penale të reja dhe së bashku me 1041 procedime penale të mbartura në hetim nga viti 2021 përbëjnë një shumë totale prej 2.307 procedime penale për t'u trajtuar gjatë këtij viti. Nga këto 370 procedime penale janë hetuar për kundërvajtje penale dhe pjesa tjetër, pra 1.937 procedime janë hetuar për krime.




Nga ana e prokurorëve është vendosur mosfillimi për 610 kallzime penale, ndërkohë që 192 kallzime penale janë në proces vlerësimi për vitin 2023. Veç këtyre, 939 procedime penale janë trajtuar për parashkrim (në dorë ose në gjykim).

|           | Totali i çështjeve të trajtuara | Procedime të reja | Të mbartuara viti parardhës | Kallzime të Mosfilluara | Trajtuar për parashkrim |
|-----------|---------------------------------|-------------------|-----------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Viti 2020 | 3214                            | 1395              | 805                         | 604                     | 410                     |
| Viti 2021 | 3721                            | 1246              | 1024                        | 737                     | 714                     |
| Viti 2022 | 3856                            | 1266              | 1041                        | 610                     | 939                     |

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:






Bazuar në analizë krahasuese, numri i çështjeve të trajtuara në total, është pak më i madh se numri i çështjeve të trajtuara në dy vitet paraardhëse.

Ndërkohë, duke ju referuar të dhënave statistikore rezultojnë se numri i mosfillimeve është ulur krahasuar me vitin 2022, saktësisht 127 materiale kallzuese të mosfilluara më pak se në vitin paraardhës. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2022 numri i procedimeve penale të regjistruara është thujtë i njëjtë në raport me vitin 2021.

Gjatë vitit 2022 është rritur numri i çështjeve penale të trajtuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, saktësisht 225 çështje më shumë se në vitin 2021, ose 31% më shumë. E rëndësishme është që nga 939 çështje për parashkrim, 747 çështje, ose rreth 80% e tyre, janë dërguar në gjyq për pushim.


**Burimet e referimit të çështjeve penale:** Përsa i përket burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2022, vendin kryesor, si çdo vit, e zenë referimet e ardhura nga Policia e Shtetit. Si gjithmonë shumica e shtetasve i drejtohen Policisë për vepra të ndryshme penale të kryera ndaj tyre. Këtë vit vihet re një rritje me rreth 12% të kallzimeve të ardhura nga shtetas dhe rreth 45% e këtyre kallzimeve është mosfilluar, pasi shtetasit i drejtohen Prokurorisë për çështje që kanë të bëjnë më pronësinë, çështje që kërkojnë një zgjidhje bazuar në të drejtën civile dhe jo penale. Pjesa tjetër e kallzimeve nga shtetasit janë regjistruar procedime penale ose janë kallzime në proces verifikimi. Nga ILDKPI edhe këtë vit, po ashtu si dhe vitin e kaluar, nuk është depozituar ndonjë kallzim penal. Gjithashtu, vihet re se kallzimet penale të referuara nga institucionet shtetërore dërgohen në seksionet përkarëse të Policisë së Shtetit, të cilat i referojnë në Prokurori. Kjo i jep shpjegim deri diku numrit të ulët të kallzimeve të ardhura nga institucionet shtetërore. Gjatë këtij viti ka 3 çështje të regjistruar kryesisht.



Ndërsa përse ju përket veprave penale të referuara, numrin më të madh të kallzimeve penale e përfshijnë veprat penale kundër pasurisë dhe fushën financiare, ku pa dyshim vendin e parë e zë vepra penale e vjedhjes, vepër që lidhet kryesisht me faktorë socialë-ekonomikë. Në masë të konsiderueshme pasojnë krimet kundër autoritetit të shtetit dhe krimet kundër personit dhe jetës.

- **Analiza krahasuese e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale:** Gjatë vitit 2022, janë përfunduar një numër i konsiderueshëm i çështjeve penale. Kështu në total janë përfunduar rreth 2269 çështje ose rreth 200 çështje më shumë se në vitin e kaluar, ndonëse numri i prokurorëve në vitin 2022 ka qënë më vogël. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë mënyrën e përfundimit të çështjeve krahasuar me dy vitet paraardhëse:

| <i>Viti</i> | <i>Totali i çështjeve</i> | <i>Mosfillim</i> | <i>Pushim</i> | <i>Dërg. Gjyq. parashk.</i> | <i>Pezullim</i> | <i>Transferim</i> | <i>Dërg. Gjykim</i> | <i>Mbetur në hetim</i> | <i>Mbetur kallzime për verifikim</i> |
|-------------|---------------------------|------------------|---------------|-----------------------------|-----------------|-------------------|---------------------|------------------------|--------------------------------------|
| 2020        | 2115                      | 604              | 242           | 410                         | 333             | 23                | 503                 | 951                    | 148                                  |
| 2021        | 2075                      | 737              | 244           | 196                         | 341             | 19                | 538                 | 946                    | 182                                  |
| 2022        | 2269                      | 610              | 240           | 747                         | 220             | 19                | 433                 | 1203                   | 192                                  |



Grafikët tregojnë se ka një rritje rreth 350% të çështjeve të dërguara në gjykatë për pushim për efekt parashkrimi duke ulur ndjeshën numrin e çështjeve të mbetura në hetim për parashkrim.

Efekti i mungesës së prokurorëve ka sjellë një rrënie rreth 20% të çështjeve të dërguara për gjykim dhe një rritje prej rreth 25% të çështjeve të mbetura në hetim, krahasuar me vitin e kaluar. Gjitashtu ka një rritje të vogël të kallzimeve të mbartura në proces vlerësimi. Ky numër më i lartë i çështjeve të mbetura në hetim, kushtëzohet në një farë mase edhe nga ndryshimi i Kodit të Proçedurës Penal, ndryshime të cilat i kanë bërë edhe trupën e prokurorëve të kenë një lloj vlerësimi dhe trajtimi më të ndryshëm të diktuar shumë herë edhe nga qëndrimet e mbajtura nga ana e Gjykatës për çështje penale të konsoliduara në protokollin e punës së prokurorisë dhe të destinuara për t'u pushuar apo mosfilluar. Nga ana tjetër vlerësojmë se mungesa e numurit të prokurorëve ka qënë një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e numurit të çështjeve të mbartura për vitin 2021 në raport me vitin paraardhës.

Numri i procedimeve penale të përfunduara (pa përfshirë parashkrimet) është 912. Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje, mënyrën e përfundimit të procedimeve penale në vitin 2022:

- **Analiza krahasuese e treguesit e të pandehurve:** Gjatë vitit 2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, janë regjistruar 1092 emra personash në hetim, nga të cilët 650 janë marë në cilësinë e të pandehurit. Janë dërguar për gjykim 601 të pandehur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga këta 25 janë dërguar për miratim urdhëri penal, 4 për gjykim me marrëveshje dhe 604 me kërkesë për dërgim në gjyq. Në krahasim me vitin 2021 konstatohet një që numur i të pandehurve në total si dhe numri i të pandehurve dërguar për gjykim, të jetë thuajse njëjtë. Mbeten në hetim 335 persona dhe të pandehur. Më poshtë jepet tabela krahasuese në tre vitet e fundit:

| Viti | Totali i regjistruar | Të pandehur | Pers. në hetim | Pushuar            | Transferuar | Push. Het. Pezulluar Çështja | Dërg për Gjykim |
|------|----------------------|-------------|----------------|--------------------|-------------|------------------------------|-----------------|
| 2020 | 1053                 | 616         | 437            | 101 pers. +4 pand. | 8 pers.     | 3 p.het.                     | 599 Pand        |

|      |      |     |     |                           |                          |          |             |
|------|------|-----|-----|---------------------------|--------------------------|----------|-------------|
| 2021 | 1140 | 679 | 461 | 123<br>pers. + 9<br>pand. | 5 pers.                  | 3 p.het. | 665<br>Pand |
| 2022 | 1092 | 650 | 442 | 88 pers.<br>+ 44<br>Pand. | 18 pers.<br>+ 3<br>pand. | 3 p.het  | 601<br>pand |

Përsa ju takon të dhënave sociale dhe demografike të të pandehurve, grupin me të madh e zenë meshkujt në masën 96%. 76 % e të pandehurve janë të papunë. Ndërkohë që 2% janë nëpunës publikë dhe 22 % i përkasin punonjësve të sektorit privat. Njëkohësisht konstatohet se në rrethin e personave të marë të pandehur për vitin 2022, rreth 79 % e zenë të pandehurit e padënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndërkohë që 3 % rezultojnë recidiviste të posaçëm, në raport me 18 % të personave që janë përsëritës, por për vepra të ndryshme penale. Ndërkohë që nëse do të analizonim nivelin arsimor të të pandehurve rezulton se 8% e personave të pandehur janë me arsim të lartë, 29% të pandehur me arsim të mesëm dhe 63% me arsim deri në 9 klasë.

• **Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2022**

Gjatë vitit 2022, nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme pune si në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim.

| Nr . | Prokurori                 | Mo<br>sfill<br>im | Gjith<br>sej<br>Proc. | Mbar<br>tur<br>Het. | Reg<br>j. E<br>Re | Gjith<br>sej<br>Përf. | Pez. | Push<br>DGj | K.Pe<br>nale<br>Push | Dërg.<br>Gjyqi<br>t | Trans. | Nën<br>Hetim | Përf.<br>Para<br>shkri<br>mi |
|------|---------------------------|-------------------|-----------------------|---------------------|-------------------|-----------------------|------|-------------|----------------------|---------------------|--------|--------------|------------------------------|
| 1    | Dh.Theodhori              | 42                | 249                   | 89                  | 160               | 163                   | 83   | 30          | 3                    | 40                  | 2      | 86           | 118                          |
| 2    | D.Nure                    | 105               | 428                   | 268                 | 160               | 123                   | 13   | 16          | 14                   | 72                  | 0      | 305          | 219                          |
| 3    | Gj.Ceka<br>Nga 01.07.22   | 46                | 134                   | 31                  | 103               | 69                    | 15   | 17          | 5                    | 30                  | 1      | 65           | 50                           |
| 4    | L.Shkurti<br>Nga 27.07.22 | 41                | 102                   | 11                  | 91                | 36                    | 3    | 6           | 5                    | 18                  | 3      | 66           | 17                           |
| 5    | L.Suçi<br>Nga 27.07.22    | 38                | 105                   | 10                  | 95                | 31                    | 5    | 3           | 3                    | 19                  | 0      | 74           | 11                           |
| 6    | O. Eminaj                 | 28                | 501                   | 306                 | 195               | 50                    | 2    | 5           | 1                    | 18                  | 2      | 451          | 85                           |
| 7    | O. Todorushi              | 75                | 359                   | 172                 | 187               | 126                   | 3    | 19          | 11                   | 79                  | 2      | 217          | 42                           |
| 8    | O. Visi                   | 121               | 257                   | 91                  | 166               | 209                   | 38   | 40          | 17                   | 103                 | 5      | 48           | 118                          |
| 9    | V.Postol<br>Nga 27.07.22  | 29                | 118                   | 20                  | 90                | 42                    | 5    | 12          | 1                    | 21                  | 1      | 76           | 10                           |

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se shumë prej prokurorëve kanë trajtuar gjatë fazës së hetimeve paraprake një numër të konsiderueshëm procedimesh dhe kallzimesh penale.

Tabela e mëposhtme jep në mënyre të detajuar statistikën e çështjeve që ka përfunduar gjykimi për çdo prokuror:

| Nr. | Prokurori               | Çështje të<br>gjykuara | Të<br>Pandehur të<br>gjykuar | Gjykuar<br>për pushim |
|-----|-------------------------|------------------------|------------------------------|-----------------------|
| 1   | Dh. Theodhori           | 30                     | 55                           | 12                    |
| 2   | D. Nure                 | 66                     | 79                           | 15                    |
| 3   | Gj.Ceka<br>Nga 01.07.22 | 4                      | 4                            | 5                     |
| 4   | L. Shkurti              | 2                      | 2                            | 3                     |

|   |                           |    |     |    |
|---|---------------------------|----|-----|----|
|   | Nga 27.07.22              |    |     |    |
| 5 | L. Suçi<br>Nga 27.07.22   | 0  | 0   | 1  |
| 6 | O. Eminaj                 | 25 | 45  | 10 |
| 7 | O. Todorushi              | 79 | 105 | 19 |
| 8 | O. Visi                   | 86 | 97  | 25 |
| 9 | V. Postol<br>Nga 27.07.22 | 4  | 6   | 1  |

- **Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake:** Gjatë vitit 2021 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 172 çështje me 252 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 61 kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga këto 115 çështje dei në 3 maj, 27 deri në 6 muaj, 11 deri në 9 muaj, 8 deri në 1 vit dhe 11 mbi 1 vit. Rrethanat që kanë çuar në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me vonesat në administrimin e akteve nga Drejtoria e Policisë Shkencore kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH Tiranë dhe informacioneve të tjera nga institucionet.

Përsa i përket kohëzgjatjes të afatit të hetimeve po japim tabelën e mëposhtme, bazuar në çështjet e përfunduara gjatë vitit 2022:

| Afati i përfundimit | 0-1 m | 1-3 m | 4-6 m | 6-9 m | 9-12 m | 1-2 v | 2-3 v | 3-4 v | 4-5 v | 5-6 v |
|---------------------|-------|-------|-------|-------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Numri i çështjeve   | 717   | 282   | 223   | 102   | 158    | 97    | 26    | 11    | 7     | 3     |

Për prokurorët nuk mund të jepet një afat individual i përfundimit hetimeve mbasi si rezultat i procesit të rivlerësimit dosjet kanë ndruar prokuror disa herë.

Gjatë vitit 2022 nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, është përballuar një ngarkesë sipas të dhënave të pasqyruara më poshtë:

| Emri i Oficerit               | Kallzime | Mosfillime | Procedime | Të Pandehur | Arrest Burg | Kundëevajje Pushuar | Dërg. Gjyq Pushim | Pezulluar | Transferuar | Dërg. Gjyqit | Përf. Çështje | Përf. Pandehur | Mbet. Het. Çështje | Hetim Pasuror | Het. Pas. Përfunduar |
|-------------------------------|----------|------------|-----------|-------------|-------------|---------------------|-------------------|-----------|-------------|--------------|---------------|----------------|--------------------|---------------|----------------------|
| Altin Malaveci                | 52       | 2          | 50        | 18          | 0           | 0                   | 13                | 20        | 0           | 9            | 42            | 9              | 8                  | 1             |                      |
| Elion Tase                    | 55       | 7          | 48        | 14          | 1           | 0                   | 4                 | 3         | 1           | 11           | 19            | 14             | 29                 | 0             |                      |
| Eliona Mydini<br>Nga 23.05.22 | 33       | 9          | 24        | 1           | 0           | 1                   | 0                 | 2         | 1           | 1            | 5             | 1              | 19                 | 0             |                      |

|   |     |    |     |    |    |    |    |    |   |    |     |    |    |    |   |
|---|-----|----|-----|----|----|----|----|----|---|----|-----|----|----|----|---|
| Gerald Blaceri  | 103 | 14 | 89  | 58 | 15 | 6  | 13 | 3  | 1 | 41 | 64  | 58 | 25 | 7  | 5 |
| Gerard Ismaili<br>01.01.22-08.02.22<br>08.08.22-vazhdim | 21  | 8  | 13  | 5  | 0  | 0  | 0  | 1  | 0 | 5  | 6   | 5  | 7  | 0  |   |
| Laert Civici  | 77  | 15 | 62  | 15 | 1  | 3  | 7  | 23 | 0 | 22 | 55  | 15 | 7  | 0  |   |
| Pandush Nando<br>Nga 23.05.2022                         | 88  | 15 | 73  | 19 | 1  | 3  | 7  | 21 | 0 | 20 | 63  | 19 | 10 | 0  |   |
| Piro Note   | 66  | 18 | 48  | 2  | 0  | 1  | 7  | 4  | 0 | 2  | 14  | 2  | 34 | 12 | 6 |
| Stela Kokoneshi   | 152 | 32 | 120 | 53 | 4  | 12 | 24 | 16 | 1 | 50 | 103 | 50 | 17 | 8  | 8 |


Ashtu siç edhe rezulton nga të dhënat e mësipërme, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, gjatë vitit 2022 kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme pune në fazën e hetimit paraprak.

## 2.4 Marrëdhëniet me publikun

Në shërbimet për publikun i është kushtuar rëndësi e veçantë korrektësisë si dhe krijimit të imazhi të mirë të institucionit. Në ndarjen e vërtetimeve lidhur me ndjekjen penale, përparësi ka pasur lehtësimi i procedurave dhe shërbimi i shpejtë për të mos krijuar pakënaqësi. Prokurori përgjegjës dhe koordinatorianë kujdesur që përgjigjet e kërkesave me shkrim, të ardhura nga shtetas apo institucione, të marin përgjigje gjithmonë brenda afatit ligjor. Gjithashtu, është krijuar, me urdhër të brendshëm, një procedurë për shërbimin e fotokopjimit, pagesës dhe dorëzimit të dosjeve penale të kërkuara nga shtetasit, që ka rezultuar efikase. Ndihma që ju është dhëna viktimave të veprës penale, apo të miturve është trajtuar në paragrafët e mësipërm.


## 2.5 Analiza e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale:

Numri i procedimeve penale të përfunduara (pa përfshirë parashkrimet) është 912. Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje, mënyrën e përfundimit të procedimeve penale në vitin 2022:



Pra prokurorët kanë vendosur dërgimin në gjykim të 433 procedime penale, ose 48% të procedimeve të përfunduara, 240 çështje janë dërguar në gjyq për pushim, 220 çështje janë pezulluar dhe 19 çështje janë transferuar. Nga 433 çështjet e dërguara për gjykim, 23 çështje apo 4% janë dërguar për miratim të urdhërit penal, 7 çështje apo 1% janë dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë dhe 4 çështje për gjykim me marrëveshje.

Çështjet e pezulluara dhe të pushuara janë thuajse të njëjta me dy vitet e mëpashme. Grafiku i mëposhtëm tregon raportin midis kundërvajtjeve penale të pushuara dhe çështjeve të dërguara në gjykatë për pushim, si dhe raportin e çështjeve të dërguar me kërkesë në seancë paraprake:



**Treguesit e mënyrës së përfundimit të gjykimit për çështjet penale të trajtuara gjatë vitit 2022.** Gjatë vitit 2022, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë janë përfunduar gjykimet e 395 çështjeve penale me 518 të pandehur.

**Urdhëri penal:** Nga 27 çështje të gjykuara për miratim urdhëri penal, Gjykata ka miratuar urdhërin në 20 çështje me 20 të pandehur dhe ka kthyer aktet në 7 çështje me 9 të pandehur, Nga këto, 4 çështje janë çuar në gjykatë me kërkesë për dërgim në gjyq dhe 3 të tjera janë në hetim.


**Gjykimi me marrëveshje:** Nga 7 çështje të gjykuara për miratim të marrëveshjes të fajsisë, Gjykata në 1 rast ka miratuar marrëveshjen dhe në 6 çështje ka urdhëruar kthimin e akteve. Çështjet e kthyera, me përjashtim të atyre që janë ende në hetim, janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për dërgim në gjyq.

**Gjykimi i drejtpërdrejtë:** Me gjykim të drejt përdrejtë ka përfunduar gjykimi në 7 çështje me 7 të pandehur.

Më konkretisht treguesit e gjykimit të çështjeve penale janë si më poshtë;

| Totali i çështjeve të gjykuara | Gjykim për miratim urdhëri penal | Gjykim me marrëveshje | Gjykim i drejtpërdrejtë | Gjykim i shkurtuar | Gjykim i zakonshëm |
|--------------------------------|----------------------------------|-----------------------|-------------------------|--------------------|--------------------|
| 395 çështje                    | 27                               | 7                     | 7                       | 336                | 18                 |

Treguesit e mësipërm paraqiten në grafikë që vijon:



Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2022, është kërkuar dënimi i 518 të pandehurve. Kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës jepen në tabelën e mëposhtme:

| Llojet e dënimeve           | Kërkesa e prokurorisë | Vendimi i gjykatës |
|-----------------------------|-----------------------|--------------------|
| Dënim me gjobë              | 63                    | 64                 |
| Dënim me burgim (minimal)   | 16                    | 2                  |
| Dënim me burgim (mesatar)   | 119                   | 197                |
| Dënim me burgim (maksimal)  | 2                     | 0                  |
| Zëvendësim Burg-Gjobë       | 0                     | 8                  |
| Qëndrimi në shtëpi          | 0                     | 1                  |
| Pezullim ekzekutimi dënimi  | 184                   | 202                |
| Punë në interes publik      | 0                     | 18                 |
| Shtrim i detyruar në spital | 3                     | 3                  |

|                      |    |    |
|----------------------|----|----|
| Burgim të përfunduar | 0  | 0  |
| Kthim aktesh         | 0  | 0  |
| Pushim Akuze         | 8  | 8  |
| Pushim çështje       | 13 | 13 |
| Pafajësi             | 0  | 2  |

- **Gjykimi për pushim:** Ka përfunduar gjykimi për pushimin e 116 çështjeve. Nga këto në 86 raste Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes dhe në 25 raste ka vendosur kthimin e akteve (në 5 çështje të tjera janë kthyer aktet në rastet e pushimit për efekt parashkrimi). Me përjashtim të çështjeve që kanë mbetur në hetim, gjithë çështjet e kthyera janë ridërguar në gjykatë për pushim.

Raporti i vendimeve të gjykatës në rastet e pushimeve jepet në grafikun më poshtë:



- **Ekzekutimet e vendimeve penale:** Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2022 rezulton se janë ekzekutuar në total 473 vendime gjyqësore të formës së prerë, krahasuar me 525 vendime në vitin 2021. Nga këto 158 urdhëra janë nxjerrë për ekzekutimin e vendimeve me burgim, 67 për ekzekutimin e dënimeve me gjobë, 2 për dënime plotësuese dhe 246 për dënime alternative.

Në lidhje me dënimet alternative, për të cilat të dënuarit nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës, duke mos u paraqitur pranë Zyrës Vendore të Sherbimit të Provës, apo gjatë kohës së provës kanë kryer një vepër tjetër penale, prokurori i ekzekutimit që ka qënë kryesisht prokurori që ka ndjekur çështjen penale ka qënë aktiv, duke kërkuar sipas rastit marjen e masave apo edhe revokimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale një prej problemeve është mungesa e adresës të saktë të të dënuarve.

**Apelimet:** Gjatë vitit 2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka paraqitur në gjykatë në total 9 ankime për masa sigurimi dhe 1 ankim për vendim themeli të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Ky numër është shumë i vogël krahasuar me 162 ankime për masë sigurimi dhe 104 ankime për çështje të shqyrtuara në themel, që kanë bërë të pandehurit.

Në rreth 71% e rasteve, për çështjet e shqyrtuara në themel, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin. Për masat e sigurimit të apeluara, gjykata ka lënë në fuqi masën e sigurimit në mbi 77% të rasteve, duke dhëna masa sigurimi më të buta për pjesën tjetër.

Ka patur një bashkërendim të mirë të punës me Prokurorinë e Apelit Korçë në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjykimit të çështjeve duke unifikuar qëndrimet dhe rakorduar praktikat për rastet e ngjashme.

## 2.6 Administrimi i Prokurorisë për vitin 2022

Puna e administratës në shërbim të prokurorëve dhe institucionit në tërësi, ka konsistuar në drejtimit e mëposhtme:



- a. Administrimi i korrespondencës hyrëse dhe dalëse është kryer nën drejtimin e kryesekretares, ndihmuar nga një sekretare dhe ftuesja. I është kushtuar rëndësi mbajtjes të librave të protokollit për materialet që lidhen me procedimet penale, protokollit që lidhet me kërkesë-ankesat e shtetasve, si dhe protokollit për materialet e cilësuar sekret. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i është kushtuar mbajtjes sipas të librit të marrëdhënieve të prokurorve me drejtuesin, që reflekton në kohë reale këto marrëdhënie.
- b. Dokumentimi i lëvizjes dhe administrimit të dosjeve penale që në momentin e mbritjes të referimit deri në arkivimin e fashikullit penal, kryhet nëpërmjet mbajtjes të rregullt të regjistrave shkresorë dhe elektronikë. Sistemi i ngritur, bën të mundur jo vetëm identifikimin e shpejtë të çështjeve penale në hetim, në gjykim apo të përfunduara por dhe përpunimin e të gjithë të dhënave të ruajtura në regjistrat elektronikë, për të nxjerë statistikak dhe informacione të tjera të kërkuara. Regjistrat shkresorë dhe elektronikë të ekzekutimit të vendimeve penale lejojnë gjithashtu, përpunimin e të dhënave në kohë reale. Sistemi CAMS përdoret për të hedhur shortin ndërsa
- c. Aktiviteti i zyrës së financës është i lidhur drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë një procesi të rregullt penal.  
Fondi i shpenzimeve operative për vitin 2022 ka qënë më i lartë se fondi i vitit 2021. Megjithatë vlerat e harxhuara për shpenzime korrente kanë qënë thuajse të njëjta krahasuar me vitin 2021.  
Ne zbatim të Udhëzimit të Prokurorisë së Përgjithshme nr. 8/2020 "Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar, zyra e financës në Prokurori ka shpenzuar për vitin 2022 për pagesat e avokateve, përkthyesve dhe eksperteve vlerën 2.893.932 lekë, që krahasuar më vlerën 3.887.820 lekë të vitit 2021 është më i ulët . Për pagesat e Institutit Mjeko Ligjor nuk janë paguar ,per mungese fondesh .  
Të ardhurat e prokurorisë nga përqindjet e shitjeve të pullave si dhe nga fotokopjimet e dosjeve, për vitin 2022, janë më të larta se në vitin 2021 dhe kapin vlerën modeste 291.600 lekë.  
Plani vjetor akorduar nga buxheti për shpenzimet është 91.714.488 lekë (pa zërin 466.2119 "mjete në ruajtje"), nga te cilat shpenzime fakti të realizuara janë 87.416.722 leke, duke aritur në masën 98.3% të planit buxhetor.
- d. Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, të mbështetura në rregulloren e etikës për prokurorët dhe për pjesën tjetër të personelit, synojnë të krijojnë, ruajnë dhe forcojnë rregullat e sjelljes, si dhe të rrisin efikasitetin e të gjithë prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore, për llogari të shoqërisë, në interes të publikut dhe në emër të shtetit, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe shtetit të së drejtës.

Në përfundim, gjej rastin, në fakt për të falenderuar të gjithë trupën e prokurorëve por edhe oficerëve të policisë gjyqësore për punën e kryer gjatë këtij viti, duke vlerësuar dhe aspiruar për rezultate akoma edhe më të mira në vijim.

## **DREJTIMET DHE PËRPARËSITË SË KËSAJ PROKURORIE GJATË VITIT 2021**

Në përfundim, pasi kemi analizuar në mënyrë sintetike të dhënat e mësipërme statistikore, duke reflektuar mbi vendimarrjet e Gjyaktës së Rrethit Gjyqësor Korçë, qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata e Apeli angazhohemi për çështjet dhe problemet e mëposhtme:

- Në vëmëndje të Prokurorisë do të jetë edhe për këtë vit, rritja e efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, duke u përpjekur për përmirësimin e ngritjes së akuzës dhe përfaqësimin sa më dinjitoz të Prokurorisë në sencat gjyqësore, por edhe gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, duke patur në vëmëndje specifike respektimin e lirisë dhe të drejtave të të pandehurve në veçanti, të pandehurve vulnerabel sikurse janë gratë, të mitur dhe personat me aftësi të kufizuar dhe padyschim edhe të viktimës, të cilës i është dhënë një vëmëndje e posaçme ligjore.
- Në vështrim të parimit të ri të pavarësisë së plotë të prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale, por edhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, do të tregohet një kujdes i veçantë në procesin e dhënies së udhëzimeve me shkrim referuar procedimeve konkrete, pavarësisht karakterit të tyre jo detyrues, por edhe udhëzimeve me natyrë detyruese për oficerët e policisë gjyqësore.
- Në vëmëndje e posaçme, në kuadër edhe të pavarësisë së prokurorisë, do të kushtohet zbatimit të njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore, në zbatim edhe të frymës dhe udhëzimeve të përgjithshme të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm
- Për të garantuar një hetim sa më efikas për kategoritë e çështjeve penale që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në komunitet, do të theksohet dhe insitohet nga ana e Prokurorëve që të përdoren metodat e hetimit proaktiv, me qëllim dhënien e një dinamike sa me adekuate luftës ndaj krimit në përgjithësi dhe krimit ekonomik në veçanti.
- Do t'u kushtohet një rëndësi specifike marrëdhënieve me policinë gjyqësore, duke qenë se roli i tyre në punën tonë të përditshme është i një rëndësie shumë të madhe. Do synohet rritja e kontrollit të prokurorit në hetimin e çështjeve duke deleguar për këtë qëllim detyra sa më të qarta dhe duke kërkuar kryerjen e tyre në një afat sa më të arsyeshëm.
- Ndër objektivat dhe prioritetet që kërkohet të arrihen nga ana jonë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten edhe marrëdhëniet me autoritetet e drejtësisë së shteteve të tjera me institucionet e ndryshme, përmirësimi i vendimmarrjes dhe rritjes profesionale te metejshme te prokurorëve dhe policisë gjyqësore.
- Do t'i kushtohet vëmëndje e veçantë rritjes së transparencës institucionale duke patur parasysh në cdo rast çështjen e karakterit sekret të hetimeve.
- Gjatë këtij viti pune, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë angazhuar në trajnime, në kryerjen e hetimeve me ndershmëri dhe seriozitet, ngritjen e akuzave të drejta e të bazuara në prova e në ligj. Ata në çdo rast kanë treguar etikë të lartë morale dhe profesionale si dhe kryerjen e punës me përkushtim dhe ndërgjegje ku gjatëushtimit të funksionit, janë mbajtur parasysh gjithmonëurdhërat e Prokurorisë së Përgjithshme.

## **DREJTUESI I PROKURORISË**

**Dhorina THEODHORI**

